Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0971

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Ebk Sh.P.K." kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Ministria e Kulturës RS dhe ÇjK" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1" me 01/03/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "Ebk Sh.P.K." me nr. 2023/971 , e datës 04/12/2023, kurse vendimi i AK "Ministria e Kulturës RS dhe ÇjK" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1".

2. **Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Kulturës RS dhe ÇjK, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 12.09.2023, Ministria e Kulturës RS dhe ÇjK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1".Ndërsa me datën 17.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "BM Group SHPK & Monting SHPK".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **530,000.00 €.**

Me 22.11.2023, OE "Ebk Sh.P.K."ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 22.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Ebk Sh.P.K." me nr. 971/23 për lidhur me aktivitetin"Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EBK SH.P.K." *janë parashtruar si në vijim:*

*Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon: "*Të nderuar ne me dt. 17.11.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë grupi OE "BM Group SHPK & Monting SHPK Veternik -Prishtinë me çmim prej:494,431.30 €, ndërsa neve kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetim te cilën e gjeni te bashkangjitur ne ankesë. Arsyeja e eliminimit është në kundërshtim të plotë me kërkesat e vendosura në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional është kërkuar si në vijim: "4. Lista e stafit profesional - Menaxheri i projektit - inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 5 vite përvojë profesionale - Udhëheqësi i punishtes - inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 3 vite

përvojë profesionale - Inxhinier i hidroteknikës - së paku 3 vite përvojë profesionale - Inxhinier i Komunikacionit - së paku 3 vite përvojë profesionale - Inxhinier i Elektroteknikës - së paku 3 vite përvojë profesionale". Kurse dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar si në vijim: "Dëshmia 4 - Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur. Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit dhe pozitave tjera. Kopjet e diplomave të noterizuara (Noterizimi jo më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). CV dhe referenca që dëshmojnë përvojën e kërkuar. Nëse OE nuk ka staf permanent atëherë si dëshmi duhet ofruar kontratat e noterizuara me emër dhe numër të projektit". Siç shihet nga kërkesa e lartpërmendur, njëra ndër kërkesat ka qenë Inxhinier i komunikacionit, ndërsa dëshmi janë kërkuar diploma, CV dhe referenca. Në lidhje me këtë kërkesë ne kemi ofruar dëshmi për z. Ahmet Zukë Krasniqi Baçelor i Komunikacionit i cili ka diplomuar me 23 Qershor 2011 dhe kemi bashkangjitur kontratën e punës, diplomën, CV dhe dëshmi për përvojën e punës. Kërkesë e dosjes së tenderit nuk ka qenë Inxhinier i diplomuar e as master i komunikacionit por vetëm fjala inxhinier i komunikacionit, prandaj dëshmia që ne kemi ofruar është e njëjtë me kërkesën e dosjes së tenderit. Në një vendim të mëparshëm të OSHP-së inxhinieri me bachelorin janë konsideruar të barasvlershëm, ndërsa ishte bërë dallimi i qartë me inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë. Vendimi në fjalë është Nr. 324-336/22 te datës 03.10.2022 dhe konstatimi është si në vijim: ndërtimtarisë. Për këtë pretendim mendoj se titulli Bachelor i ndërtimtarisë dhe Inxhinier i ndërtimtarisë, janë Ekuivalcnt apo te barasvlershme, por kjo më së lehti mund të krahasohet përmes sistemit te pikëve (Kredive-ECTS), dhe për këtë AK mund te kërkoj sqarime sipas nenit Pra në rastin tonë titulli Bachelor i Komunikacionit është i barasvlershëm me kërkesën e dosjes së tenderit Inxhinier i Komunikacionit. Pra ekziston dallim i qartë kur kërkesa është inxhinier i diplomuar me inxhinier dhe bachelor. Në rastin konkret nuk kemi kërkesë inxhinier të diplomuar por vetëm inxhinier, ndërsa eliminimi nuk mund të bëhet me arsyen se nuk kemi ofruar inxhinier të diplomuar, sepse mund të veprohet në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së. Pra nuk mund të eliminohemi për një kërkesë e cila nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë. Me dt.22.11.2022 ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ku AK-ja e ka refuzuar me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar. AK-ja në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e ka cekur se është kërkuar diploma dhe i bie se është kërkuar inxhinier i diplomuar. Vlerësimet e ofertave nuk mund të bëhen me fjalën i bie por duhet të bëhet në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. Diplomë edhe ne kemi ofruar si dëshmi për z. Ahmet Krasniqi, e në diplomë shkruan "Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Diplome e studimeve themelore universitare, Ahmet Zekë Kraniqi" .Autoriteti kontraktues më tutje është munduar të bëjë krahasime me vitet e studimit të inxhinierit të diplomuar me vitet e Bachelorit, mirëpo ju sqarojmë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kërkesë për inxhinier të diplomuar por vetëm me inxhinier, prandaj këto krahasime nuk janë reale. Po ashtu kërkesë e dosjes së tenderit nuk ka qenë vitet e studimit, prandaj me këtë rast nuk gjejnë zbatim vitet e studimit. Sa i përket viteve të studimit, ju sqarojmë se me sistemin e vjetër me shkollë të lartë është marr titulli inxhinier, prandaj studenti që ka përfunduar studimet bachelor rezulton se ka më shumë vite të studimit se sa inxhinieri. Studimet bachelor zgjasin tri vite, ndërsa titulli inxhinier është marr me 2 ose 2.5 vite studim. Edhe në përgjigje autoriteti kontraktues nuk ka arrit të dëshmojë të kundërtën e asaj që ne kemi pretenduar. AK-ja ka

theksuar se për tu marr titulli inxhinier duhet të studiohet 4 vite ose të merren 240 kredi, mirëpo askund nuk e mbështet në ndonjë literaturë por vetëm thirret në Europian Education Area. Autoriteti kontraktues më pastaj e ka cekur se me modulet e vjetra të sistemit arsimor në Republikën e Kosovës inxhinier paraqitet një person apo individ i cili ka të përfunduar studimet më së paku 240 kredi dhe me kohëzgjatje së paku 4 vite. Ky konstatim është plotësisht i paqëndrueshëm sepse me sistemin e vjetër e sqaruam më lartë se i është marr titulli inxhinier, ndërsa ne nuk e dimë se çka kanë nënkuptuar AK-ja me modulin e vjetër. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Në këtë rast nuk është marr parasysh edhe neni 6 i LPP-së ekonomiciteti kur dihet se ne kemi ofruar çmim shumë më të lirë, dhe në krahasim me OE e rekomanduar për kontratë ne jemi më të lirë prej 62,431.30 euro. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Ebk Sh.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 7, 59, 60, të LPP-së. Ne kërkojmë nga OSHP që të merr vendim që të Aprovohet ankesa e OE "EBK" SH.P.K si e bazuar, Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim,Detyrohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: *"*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Ligji për Arsim të Lartë në Republikën e Kosovës janë mjetet dhe institucionet që paraqesin barasvlerën e një titulli akademik dhe jo vendimet e OSHP-së (edhe vendimet e OSHP-së, edhe vendimet e AK-së, edhe pretendimet e OE mund të janë gabim), në këtë rast specifikohet qartë Bachelori nuk është në barasvlerën e Inxhinierit, sepse për të marrë një diplomë të inxhinierit duhet të kesh se paku 4 Vite studime dhe të kesh se paku 240 kredi, ndërsa një diplome Bachelori e përcaktuar edhe me rregulla ndërkombëtare të paraqitura edhe nga European Education Area - Quality education and training for all ka 180 kredi deri në 240, dhe se me modulet e vjetra të sistemit arsimor në Republikën e Kosovës, Inxhinier paraqitet një person apo individ i cili ka të përfunduar studimet me se paku 240 kredi dhe me një kohëzgjatje se paku 4 Vite (me sistemin e ri 3+2 vite).Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Inxhinier të Komunikacionit dhe ne të njëjtën kohë ka kërkuar Diplomën (Shiko kriterin: Kopjet e diplomave të noterizuara – Noterizimi jo më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), pra i bije se e

ka kërkuar një Inxhinier të Diplomuar të Komunikacionit, sepse një person i pa diplomuar nuk mund të llogaritet Inxhinier. Në këtë rast duke analizuar foton l , shihet qartë se OE i eliminuar ka paraqitur një Bachelor të Komunikacionit i cili nuk ka plotësuar kushtin e Autoritetit Kontraktues sepse i njëjti është me një vit me pak se sa shkollimi i kërkuar nga AK. Në anën tjetër OE i rekomanduar ka paraqitur në ofertën e tij një Inxhinier të Diplomuar të Makinerisë në Drejtimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues atë të Komunikacionit. Ju lutem pranoni referencat për të parë në detaje kalkulimin e gradave ECTS (kredive) nga nje Organizatë prestigjiozë si ajo: German Grade Calculator (https://germangradecalculator.net/ectscalculator/#:—:text=10/9201.points.0/02060/020The%20doctorate%20program%20comprises%2040%20points) ku specifikohet në detaje dallimi për atë që jeni eliminuar.Operatori Ekonomik anikimues ka paraqitur 2 herë detajin se Oferta e tyre është me e lirë se sa oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë dhe se me këtë do të dëmtohet buxheti dhe behet "zhagitje" e procedues. AK Kontraktues njofton palën ankimuese se Oferta e rekomanduar për kontratë është një ofertë e paraqitur nën kuadratin e vlerës se paraparë për investim në këtë projekt dhe se as ju si Operator Ekonomik ankimues nuk keni paraqitur asnjë gjetje për ta do të thotë se oferta e tyre është e përgjegjshme dhe nën vlerën e parashikuar. Duke e ditur që procedura kishte për qëllim të shpërblente me kontratë një OE i cili ka çmimin me të ulët pasi që të këtë plotësuar të gjitha kriteret administrative për kontratë dhe ju në këtë rast keni mungesë të dokumentacionit. Për të ju bindur qe jeni gabim, në një procedurë tjetër me kriteret identike apo të ngjashme ju si Inxhinier të Komunikacionit keni bashkangjitur një Inxhinier të Komunikacionit dhe jo punëtorin në fjalë që e keni bashkangjitur në AP - Renovimi i palestrave ekzistuese sportive në qendrat regjionale — Palestra Sportive në Shtime me numër 207-23-97165-1-1.*”*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 971/23, ndërsa me datë 11.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/971 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është Pajtuar me mendimin e ekspertit .

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “EBK SH.P.K.”- *eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/971 ka vlerësuar si në vijim:*

*Konstatimi i parë (I): "*Aktiviteti i prokurimit: "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 13.09.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 23.10.2023, ku AK me datë 17.11.2023 publikon njoftimin B58 duke rekomanduar për kontratë OE "BM Group Shpk & Monting Shpk" , ndërsa OE ankuesin ka eliminuar me arsyetimin: "Për kërkesën Inxhinieri i komunikacionit keni prezantuat z. A .K i cili është Bachelor i Komunikacionit, dhe ky titull akademik nuk e plotëson kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues" Tutje, pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 04.12.2023 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ka eliminuar pa drejtësisht OE ankuesin dhe se AK ka shkelë nenin 1,7,59,60 të LPP-së. Pretendimi i OE ankues është parashtruar kundër eliminimit të tij, për faktin se i njëjti është më i lirë me çmim dhe se pretendon që plotëson kriteret në Dosje të tenderit. Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron, AK në dosje të tenderit ka kërkuar 9.1&9.2 : 4. Lista e stafit profesional - Menaxheri i projektit – inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 5 vite përvojë profesionale - Udhëheqësi i punishtes – inxhinier i ndërtimtarisë me së paku 3 vite përvoje profesionale - Inxhinier i hidroteknikës - së paku 3 vite përvoje profesionale - Inxhinier i Komunikacionit - së paku 3 vite përvojë profesionale - Inxhinier i Elektroteknikës - së paku 3 vite përvoje profesionale Dëshmia 4 - Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur. Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit dhe pozitave tjera. Kopjet e diplomave të noterizuara (Noterizimi jo më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). CV dhe referenca që dëshmojnë përvojën e kërkuar. Nëse OE nuk ka staf permanent atëherë si dëshmi duhet ofruar kontratat e noterizuara me emër dhe numër të projektit. Fillimisht, sa i përket pretendimit të ngritur nga OE ankues, meqë nuk jemi kompetent që të trajtojmë barasvlerën e titullit, atëherë kemi kërkuar sqarim nga Universiteti i Prishtinës(UP)- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike(FIM), lidhur me këto diploma si dhe me kualifikimin e marrë. UP-FIM, ka kthyer përgjigje citojmë:"Diplomat sipas sistemit te para-Bolonjes nga Fakulteti ynë lëshohen me thirrjen: p.sh. Inxhinier i diplomuar i makinerisë, drejtimi komunikacion Fakulteti deri me tani nuk ka lëshuar diploma me thirrjen inxhinier i komunikacionit. Bazuar ne UA te cekura me larte Inxhinieri i diplomuar i makinerisë është i barasvlershëm me Master te Inxhinierisë Mekanike tani. Qartësojmë se, AK në DT ka kërkuar inxhinier i komunikacionit, mirëpo gjithashtu AK nuk ka parashtruar qartë kriteret, për faktin se sipas UP-së nuk ka titull Inxhinier të komunikacionit, por ka Inxhinier të diplomuar të makinerisë- drejtimi Komunikacion, që pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Tutje, OE i rekomanduar posedon inxhinierin e diplomuar të makinerisë drejtimi komunikacion, kurse OE ankuesi ka ofruar inxhinierin i cili posedon diplomën bachelor i komunikacionit. Ndërsa, pretendimi tjetër i OE ankues lidhur me inxhinierin dhe inxhinieri i diplomuar dallojnë, UP sqaron citat (FIM):" Sqarim: Me sistemin e para-Bolonjes ka pas dallim p.sh ndërmjet inxhinierit te makinerisë përkundër inxhinier i diplomuar i makinerisë. Thirrja inxhinier i makinerisë është marrë ne Shkollat e Larta, 5 semestra, 2.5 vite. Thirrja inxhinier i diplomuar i makinerisë është marrë në Fakultet, studime 4-5 vjeçare" Në rastin konkret, në ofertat e tyre, kemi inxhinier të cilët në UP janë të regjistruar me sistem para bolonjës, studimet kanë përfunduar me sistem të bolonjës, pra në vitin 2011. Gjithashtu, në web faqe të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike drejtimi Komunikacion dhe transport, trajtohet si Inxhinieri i komunikacionit Dhe si e tillë, konform edhe vendimit të OSHP-së PSH. Nr:324-336/22, në cilën flitet për inxhinier të ndërtimtarisë dhe inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, si e tillë konsideroj se, kjo diplomë është e barasvlershëm me "kërkesën e dosjes së tenderit", e cila nuk është e specifikuar mirë. Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, gjithashtu edhe bazuar në natyrën e aktivitetit të prokurimit "Renovim i

palestrës sportive", konsideroj se aktiviteti i prokurimit në fjalë, duhet të kthehet në rivlerësim, duke rekomanduar AK-në që procesin e rivlerësimit të zhvilloj konform dispozitave ligjore të LPP-së. Ky rekomandim vie me arsyetimin se, fillimisht AK nuk ka vendosur kritere të qarta dhe të specifikuara mirë, vendimi PSH nr. 324-336/22, si dhe marrë parasysh nenin 6 të LPP-së, OE ankuesi ka ofertuar çmimin më të ulët për 60 mijë euro."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EBK SH.P.K." Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ebk Sh.P.K." janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ebk Sh.P.K." dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ebk Sh.P.K." janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1", të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me "Renovimi i palestrave ekzistuese sportive ne qendrat regjionale – Palestra Sportive ne Shtime" me nr. të prokurimit: "207-23-9716-5-1-1" të rivlerësohet AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP, konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të

kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **EBK SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: